

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6791  
E hënë, 27 dhjetor 2022  
çmimi 0.40

## Krasniqi, thirrje Kurtit Hiqi barrikadat, po rrezikohet sovrانيتi i vendit



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI, NË DITËN E 17 QË NGA VENDOSJA E BARRIKADAVE, KA MBAJTUR TAKIM TË KËSHILLIT TË SIGURISË TË KOSOVËS LIDHUR ME SITUATËN NË VERI

# KURTI PRET KFOR-in T'I HEQË BARRIKADAT

FAQE 4-5



Pas një takimi të Këshillit të Sigurisë të Kosovës, të mbajtur të hënën, Zyra e Kryeministrit ka theksuar se Qeveria e Kosovës është ende "në pritje të veprimeve

nga KFOR-i" për heqjen e barrikadave. Në komunikatën për medie thuhet se gjatë këtyre 17 ditëve Qeveria e Kosovës "ka pasur komunikim të vazhdueshëm

me KFOR-in" dhe përsëritet se edhe pse "Policia e Kosovës i ka të gjitha kapacitetet dhe gatishmërinë për të vepruar", qeveria është në pritje të KFOR-it

## AKTUALE



**DHJETËRA TË VDEKUR NË SHBA DHE KANADA NGA TË FTOHTIT** F.2

**UKRAINA DO TA KËRKOJË PËRJASHTIMIN E RUSISË NGA KËSHILLI I SIGURIMIT** F.2

**MBAHET EDICIONI I SHTATË I "VRAPO BABADIMËR"** F.6




## EKONOMI




**BANKAT KOMERCIALE NË KOSOVË NUK PAGUAJNË TATIM NË DIVIDENTË** F.8

## SPORT




**FITORE ME PËRMBYSJE E PEJËS** F.12



## VITIA RIKTHEHET NË POZITËN E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË, OPOZITA E QUAN LAJM TË KEQ

FAQE 3



## RAFUNA: KOSOVA NË RREZIK NGA RECESIONI EKONOMIK

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Dhjetëra të vdekur në ShBA dhe Kanada nga të ftohtit

WASHINGTON, 26 DHJETOR - Të paktën 51 persona kanë mbetur të vdekur shkaku i temperaturave të ulëta në Amerikën e Veriut. Zyrtarët thonë se 47 persona kanë vdekur në nëntë qytete të ShBA-së, ndërsa zona më e prekur është qyteti i Bufalos në Nju-Jork. Ndërkohë, katër vdekje janë shënuar në Kanada, ku një autobus rrëshqiti mbi rrugën e ngrirë afër qytetës Merit, në provincën perëndimore të Kolumbisë Britanike.

Një stuhi e tillë kaq e madhe nuk është regjistruar asnjëherë më parë. Ajo shtrihet nga Kanadaja deri në pjesën jugore të Rio Grandes.

Meteorologët thonë se stuhia do të dobësohet gjatë ditëve të ardhshme, mirëpo qytetarët këshillohen t'i shmangin udhëtimet përveç në raste emergjente.

Stuhia ka shkaktuar dëme të mëdha, por energjia elektrike është restauruar në pjesën më të

madhe të ShBA-së. Më pak se 200 mijë njerëz mbetën pa rrymë gjatë pasdites të së dielës, në krahasim me 1.7 milion që ishin në terr më parë, raporton AP.

Mbi 15 mijë fluturime janë anuluar gjatë ditëve të fundit, duke ua pamundësuar kështu shumë njerëzve kthimin në shtëpi në kohë për festën e Krishtlindjes.

Mbi 55 milionë amerikanë ishin paralajmëruar edhe për erëra me ngrica të dielën. Stuhia dimërore e "ciklonit bombardues" - e cila ndodh kur presioni atmosferik bie, duke shkaktuar borë të dendur dhe erëra - ka ndërprerë udhëtimet nëpër ShBA.

Gubernatorja e Nju-Jorkut, Kathy Hochul, me origjinë nga Buffalo, tha: "Kjo do të hyjë në histori si stuhia më shkatërruese në Buffalo". "Është [si] të shkosh në një zonë lufte dhe veturat përgjatë rrugëve janë tronditëse", u tha ajo gazetarëve të dielën në mbrëmje.

Banorët ende po përballen me



një "situatë shumë të rrezikshme, kërcënuese për jetën" dhe kushdo që gjendet në atë zonë duhet të qëndrojë brenda, tha ajo.

Të paktën 25 vdekje u konfirmuan në zonën Erie, ku disa viktime u gjetën të vdekur në makina ose në dëborë.

Vdekje të lidhura me këtë stuhi u

raportuan edhe në Vermont, Ohajo, Misuri, Uiskonsin, Kansas dhe Kolorado. Temperaturat në Floridën e Jugut ranë aq shumë sa që iguanat u ngrinë dhe u rrëzuan nga pemët.

Shteti amerikan në pjesën perëndimore të vendit, Montana, ka qenë më i godituri nga të ftohtit, me temperatura që

bien deri në -45 gradë celsius.

Në Kanada, provincat e Ontarios dhe Kuebekut kanë pësuar dëmet më të mëdha nga kjo stuhi. Në Kuebek pothuajse 120 000 njerëz mbetën pa energji elektrike të dielën.

Zyrtarët thonë mund të duhen disa ditë derisa t'i lidhin sërish të gjitha shtëpitë me rrjetin elektrik.

## Ukraina do ta kërkojë përjashtimin e Rusisë nga Këshilli i Sigurimit

KIEV, 26 DHJETOR - Ukraina pritet ta kërkojë të hënën përjashtimin e Rusisë nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (OKB), dhjetë muaj që nga nisja e ofensivës ruse në Ukrainë, ndërkohë që lideri i Rusisë, Vladimir Putin, po e akuzon Perëndimin se po tenton ta "shkatërrojë" vendin e tij.

Të dielën ministri ukrainas i Punëve të Jashtme, Dmytro Kuleba, tha se Kievi zyrtar do të kërkojë që Rusisë t'i hiqet statusi si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së ku e ka një ulëse bashkë me ShBA-në, Britaninë e Madhe, Francën dhe Kinën. "Nesër ne do ta shprehim zyrtarisht qëndrimin tonë. Ne e kemi një pyetje shumë të thjeshtë: A ka Rusia të drejtë të mbetet anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit dhe thjeshtë të jetë në Kombet e Bashkuara?", tha Kuleba.



"Ne e kemi një përgjigje bindëse dhe të arsyeshme. Jo, nuk ka [të drejtë]."

Pesë anëtarët e përhershme të Këshillit të fuqishëm të Sigurimit, me 15 ulëse, kanë të drejtën e vetos që mund ta përdorin për ta bllokuar çfarëdo rezolute.

Të dielën presidenti rus Putin tha se

ofensiva e tij në Ukrainë ka për qëllim ta "bashkojë popullin rus", ndërsa i akuzoi "kundërshtarët gjeopolitik" se synojnë ta shkatërrojnë "Rusinë historike".

Putini e ka përdorur konceptin e "Rusisë historike" për të argumentuar se ukrainasit dhe rusët janë një popull, duke kundërshtuar

kështu sovranitetin e Kievit dhe duke e arsyetuar ofensivën në Ukrainë. "Përçarje dhe mposhtje, këtë kanë kërkuar gjithmonë ta arrijnë dhe vazhdojnë ta synojnë", tha Putini në një intervistë televizive.

"Por, qëllimi ynë është tjetër: ta bashkojmë popullin rus".

Ai përsëriti se Moska është e

gatshme për negociatë dhe u duk i qetë kur u pyet për sistemin e ri të mbrojtjes ajrore me të cilin ShBA-ja do ta furnizojë Ukrainën. "Natyrisht se do ta shkatërrojmë atë, 100 për qind!", tha Putini, duke iu referuar sistemit të mbrojtjes ajrore "Patriot" që iu premtua presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky.

Javën e kaluar Zelensky mori zotime për përkrahje nga Uashingtoni gjatë vizitës së tij të parë jashtë Ukrainës që nga nisja e luftës në shkurt.

Ndihmat financiare dhe ushtarake nga Perëndimi kanë qenë kyçe në fitoret ukrainase kundër ushtrisë ruse, përfshirë këtu atë në Herson, kryeqytetin e vetëm rajonal që kontrollohej nga Rusia.

Edhe pse Rusia është mbrapsur nga Hersoni, qyteti mbetet brenda rrezes së armëve ruse dhe është nën rrezik të vazhdueshëm.

## Mbi 50 persona me simptoma të helmimit në Pirot të Serbisë

PIROT, 26 DHJETOR - Në qytetin Piro, në juglindje të Serbisë, është shpallur gjendje e jashtëzakonshme, pasi 51 persona u dërguan në spital me simptoma të helmimit, shkaku i rrjedhjes së amoniakut pas përmbysjes së një vagoni të një treni mallrash mbrëmjen e së

dielës, më 25 dhjetor. Kryetari i komunës së Piro, Vladan Vasiq, shpalli gjendje të jashtëzakonshme në këtë qytet, njoftoi TV N1, përderisa shkollat në atë qytet janë të mbyllura të hënën.

Sipas informacioneve nga Qendra Klinike Universitare në Nish,

në atë spital janë shtruar 15 persona, 12 të rritur dhe tre fëmijë - për shkak të simptomave të helmimit. Në njoftim theksohet se të gjithë pacientët janë në gjendje stabile dhe jashtë rrezikut për jetë dhe shtojnë se ata janë shtrirë në spital gjatë natës.





# Vitia rikthehet në pozitën e ministrit të Shëndetësisë, opozita e quan lajm të keq



Kryeministri Albin Kurti ka emëruar përsëri Arben Vitinë ministër të Shëndetësisë. Kjo do të jetë hera e tretë që Arben Vitia do ta udhëheqë Ministrinë e Shëndetësisë. Partitë e opozitës rremërimin e Vitisë sërish ministër e kanë quajtur lajm të keq për shëndetësinë. Për rremërimin e Arben Vitisë në pozitën e ministrit të Shëndetësisë ka pasur reagime edhe nga shoqëria civile, e cila e ka vlerësuar hap jo të mirë rikthimin e tij në krye të shëndetësisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 26 DHJETOR** - Zyra e Kryeministrit ka bërë me dije të hënën se Arben Vita është rremëruar ministër i Shëndetësisë me vendim të kryeministrit Albin Kurti. "Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, sot ka emëruar Arben Vitinë ministër i Shëndetësisë, të cilit i ka uruar suksese në plotësimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij", thuhet në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Vitia kishte dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit të Shëndetësisë në tetor të vitit të kaluar për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale për kryetar në komunën e Prishtinës, garë të cilën e kishte humbur kundër kandidatit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Përparim Rama. Vitia kishte shërbyer ministër i

Shëndetësisë edhe në qeverinë Kurti I më 2020.

Pas dorëheqjes së tij, rreth një muaj më vonë, ministër i Shëndetësisë ishte emëruar Rifat Latifi. Por, ky i fundit dha dorëheqje më 6 tetor, gati një vit pas marrjes së detyrës. Që nga atëherë Kosova ishte me ushtruese detyre të ministres së Shëndetësisë, Dafina Gexha-Bunjaku.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës në shtator kishte themeluar Komisionin Ekzekutiv për Shëndetësi i cili udhëhiqet nga kryeministri Kurti. Sipas vendimit të qeverisë, disa nga përgjegjësitë e këtij komisioni janë zhvillimi i sistemit informativ i sistemit shëndetësor në të gjitha nivelet e sektorit publik dhe privat, analiza dhe definimi i ndarjes dhe bashkëpunimit publiko-privat në shëndetësi si dhe reforma të tjera

në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Ky komision deri më tani ka zhvilluar disa takime.

## Opozita: Riemërimi i Arben Vitisë është lajm i keq për shëndetësinë tonë

"Me rremërimin e Arben Vitisë, LV vazhdoi degradimin e shëndetësisë duke e vendosur pozitën e ministrit të Shëndetësisë në pazar dhe interes të sektorit privat", kështu ka thënë deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu.

Ai ka një pyetje për kryeministrin Albin Kurti pas rremërimin të Vitisë në postin e ministrit të Shëndetësisë. "Pyetja që i duhet bërë sot Albin Kurtit është se, a ka dhënë ende dorëheqje nga Komision Ekzekutiv për

Shëndetësi, a është më mirë pa ministër apo me një ministër të dështuar me konflikt të supozuar të interesit? Albin Kurti duhet të japë përgjegjësi dhe të tregojë se përse që tre muaj nuk është emëruar ministri i Shëndetësisë, apo ka pritur derisa Arben Vitia të përfundojë barazimet me sektorin privat?", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

Ai ka theksuar se "Duke ditur se Arben Vitia nga pozita e ministrit të Shëndetësisë, shkoj menaxher në laboratorin 'Olive' e tani sërish është rikthyer në ministër, dyshohet për konflikt të interesit. Pas Raportit të Auditorit për vitin 2021, ku ishin gjetur afro 12 milionë euro keqpërdorime në shëndetësi në kohën sa ky dikaster udhëhiqej nga Arben Vitia, rremërimi i Arben Vitisë është lajm i keq për shëndetësinë tonë", ka thënë deputeti Haxhiu. Nuk e ka mirëpritur mirë rremërimin e Vitisë as deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj. Ai ka theksuar se ministri i Shëndetësisë nuk ndryshon dhe qasja nuk ndryshon. "Ndaj, dështimi e

degradimi vazhdon. Zoti i ruajt mjekët e infermierët e mbetur në vend si dhe pacientët që kanë nevojë për shërim!", ka shkruar Zemaj në "Facebook".

Edhe Nol Nushi nga PSD-ja ka reaguar, duke theksuar se Vitia është një kukull e Kurtit dhe LV-së. "Degradimi i shëndetësisë nuk mbulohet me mindilin e Arbenit", ka thënë Nushi.

Për rremërimin e Arben Vitisë në postin e ministrit të Shëndetësisë ka pasur reagime edhe nga shoqëria civile, e cila e ka vlerësuar hap jo të mirë rikthimin e tij në krye të shëndetësisë. "D.m.th. 79 ditë e ka lënë Albini shëndetësinë pa ministër për ta kthyer prapë Arben Vitinë. Ndoshta është dashë me e pritë fundin e vitit për t'i përfunduar kontrata me spitalin privat", ka shkruar në "Facebook" opinionisti Imer Mushkolaj. Vitia pasi pati dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit për të garuar për kryetar të Prishtinës, në paraqitjet e tij në medie pati theksuar se, pavarësisht nëse do të fitojë a jo në kryeqytet, ai nuk do të rikthehet në pozitën e ministrit.

## Ndalohe për 48 orë zyrtarja policore që shkaktoi aksident me fatalitet në Novosellë të Pejës

**PEJË, 26 DHJETOR** - Një person ka humbur jetën ndërkaq tre të tjerë janë lënduar si pasojë e një aksidenti në Novosellë të Pejës gjatë së hënës. Të lënduarit janë dërguar me urgjencë në Spitalin e Pejës pastaj për në QKUK.

"Sot rreth orës 7:45 policia është njoftuar se ka ndodhur një aksident në Novosellë mes dy veturave. Si pasojë e aksidentit janë lënduar tre

persona të cilët me urgjencë janë dërguar për trajtim mjekësor në spital, kurse më vonë me udhëzim të mjekut janë transportuar për në QKUK për shkak të lëndimeve të rënda", ka thënë Gashi.

Ndërkaq zëdhënësi i Prokurorisë Themelore të Pejës, Shkodran Nikçi, ka thënë se pas marrjes së tretmanit mjekësor, personi që ka shkaktuar aksidentin me

urdhër të prokurorit të shtetit është ndaluar për 48 orë nën dyshimin se ka kryer veprën penale "Rrezikimi i trafikut publik". "Brenda afatit ligjor prokurori i shtetit do të marrë veprime për sigurimin e prezencës së të pandehurës në procedurë penale", tha më tej Nikçi.

Bëhet me dije se shkaktimi i aksidentit është bërë nga një zyrtarë e Policisë së Kosovës.







KRYEMINISTRI ALBIN KURTI, NË DITËN E 17 TË VENDOSJES SË BARRIKADAVE, KA MBAJTUR TAKIM TË KËSHILLIT TË SIGURISË TË KOSOVËS LIDHUR ME SITUATËN NË VERI

## Kurti pret KFOR-in t'i heqë barrikadat

Pas një takimi të Këshillit të Sigurisë të Kosovës, të mbajtur të hënën, Zyra e Kryeministrit ka theksuar se Qeveria e Kosovës është ende “në pritje të veprimeve nga KFOR-i” për heqjen e barrikadave. Në komunikatën për medie thuhet se gjatë këtyre 17 ditëve Qeveria e Kosovës “ka pasur komunikim të vazhdueshëm me KFOR-in” dhe përsëritet se, edhe pse “Policia e Kosovës i ka të gjitha kapacitetet dhe gatishmërinë për të vepruar”, qeveria është në pritje të KFOR-it

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Këshilli i Sigurisë të Kosovës ka diskutuar më 26 dhjetor për situatën e krijuar në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe. Mbledhja u thirr nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe në të u diskutua për “incidentet e fundit të shkaktuara nga strukturat ilegale dhe grupet kriminale, të koordinuar dhe mbështetura nga Qeveria e Serbisë” që, sipas Qeverisë së Kosovës, po veprojnë kundër rendit kushtetues. “Qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës nuk mund të dialogojnë me banda kriminale, ndërsa u potencua se liria e lëvizjes duhet të rivendoset dhe se nuk duhet të ketë barrikada në asnjë rrugë”, u tha në njoftim. Qeveria tha se është në

komunikim të vazhdueshëm me misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR, dhe po pret që ai të veprojë, duke theksuar se Policia e Kosovës ka të gjitha kapacitetet për t'i hequr barrikadat. “Strukturat ilegale si dhe grupet kriminale po vazhdojnë të kryejnë akte ekstremiste ndaj qytetarëve të Republikës, institucioneve shtetërore, ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, gazetarëve, ndaj pjesëtarëve të misionit të EULEX-it dhe njësive patrulluese të KFOR-it”, u tha në njoftim.

Për 17 ditë me radhë rrugët që çojnë drejt pikave kufitare Jarinjë dhe Bërnjak që lidhin Kosovën me Serbinë janë të bllokuara nga barrikadat e ngritura nga disa serbë lokalë. Serbët i ngritën barrikadat pas arrestimit të ish-policit të Kosovës, Dejan Pantiq, i cili, sipas autoriteteve të Kosovës, dyshohet për organizimin e

një sulmi ndaj zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është takuar të hënën me komandantin e forcave paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë (KFOR), Angelo Michele Ristuccia, dhe shefin e EULEX-it, Lars Gunnar Wigemark.

Sipas komunikatës së lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, “konstatim i përbashkët nga ky takim është se liria e lëvizjes duhet të rivendoset dhe se nuk duhet të ketë barrikada në asnjë rrugë”.

Në takimin e së hënës morën pjesë edhe zëvendëskryeministri i parë, Besnik Bislimi, dhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ndërsa për takimin njoftoi edhe KFOR-i në platformën “Twitter”.

“Sot komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele

Ristuccia, u takua me zotëri Albin Kurtin dhe zotëri Lars-Gunnar Wigermark për të diskutuar për situatën e sigurisë në Kosovë”, thuhet në postimin e KFOR-it.

Ndërkohë, zyra e kryeministrit tha se në takim u fol edhe “lidhur me veprimet e strukturave kriminale në veri të Republikës së Kosovës, që cenojnë rëndë sigurinë në vend” dhe u theksua se do të vazhdojë bashkëpunimi ndër-institucional.

Më parë, të hënën, KFOR-i bëri me dije se është duke e hetuar atë që e ka quajtur “incident jodirekt zjarri” më 25 dhjetor, kur u raportua për të shtëna afër një patrulle të KFOR-it në Zubin Potok - njëra nga katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës.

KFOR-i ka bërë thirrje që të gjitha palët e përfshira “ta shmangin retorikën apo veprimet që mund të shkaktojnë tensione dhe mund ta përshkallëzojnë situatën”, ndërsa ka thënë se “mbetemi vigjilentë dhe plotësisht të aftë ta përmbushim mandatin tonë sipas Rezolutës 1244 të vitit 1999 për të gjitha komunitetet

në Kosovë”. “Komandanti i misionit të KFOR-it vazhdon ta përkrahë dialogun për ta gjetur një marrëveshje për zbutjen e tensioneve në veri të Kosovës. Ai mbetet në kontakt të ngushtë me të gjithë të përfshirët në këtë proces”, thuhet më tutje në njoftimin e KFOR-it.

### Serbë të maskuar sërish sulmojnë gazetarët

Të hënën sërish është sulmuar ekipi i “Klan Kosovës” në Zubin Potok. Gazetarja Qëndresa Bellagoshi dhe shoferi Elsad Sinani kanë pësuar lëndime të lehta, kurse kameramani Agon Bejtullahu dhe gazetari Drin Demiri nuk janë lënduar. Xhamat e veturës janë thyer. Sulmi ka ndodhur nga serbë të maskuar në fshatin Zupç në Zubin Potok.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë e ka dënuar këtë incident duke thënë se sulmet e tilla janë të papranueshme. “Ky dhe incidentet e mëparshme që e ndikojnë punën e medieve janë të papranueshme. Mediet kanë



çdo të drejtë të raportojnë. Siguria e tyre nuk duhet të rrezikohet”, thuhet në reagimin e Zyrës së BE-së, e cila i dëshiroi shërim të shpejtë ekipit të gazetarëve. Edhe Shtetet e Bashkuara kanë dënuar sulmin ndaj gazetarëve në veri. “Mediet duhet të jenë në gjendje të punojnë pa kërcënime të dhunës dhe frikësime. Një shtyp i lirë, i pavarur, është themel i demokracisë”, ka shkruar ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier në “Twitter”.

Edhe Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka shprehur shqetësim lidhur me sulmet ndaj gazetarëve në veri, ku deri më tani janë raportuar gjashtë incidente të tilla për të cilat ka thënë se janë “kërcënim serioz për sigurinë e gazetarëve dhe pengojnë raportimin për zhvillimet në veri”. “AGK-ja kërkon nga KFOR-i dhe EULEX-i që të luajnë rol shtesë për të garantuar sigurinë fizike të gazetarëve, që vazhdojnë të jenë cak i sulmeve të organizuara nga grupe personash të maskuar”, thuhet në reagimin e AGK-së.



## Krasniqi, thirrje Kurtit: Hiqi barrikadat, po rrezikohet sovraniteti i vendit

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i ka bërë të hënën sërish thirrje Qeverisë së Kosovës që të jetë vigjilente dhe të reagojë sa më shpejt për t'i hequr barrikadat të cilat, siç tha lideri i opozitës, janë kthyer në punkte të Vuçiqit, si tentim për ndarjen e Kosovës. “Në ditën e 17 të vendosjes së barrikadave në pjesën veriore të Kosovës, kryeministri Kurti realizoi edhe një takim me KFOR-in. Mbajti edhe mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Dhe cili është rezultati? Barrikadat mbesin, shpërthimet në pjesën veriore vazhdojnë, sulmet ndaj gazetarëve vijnë e shtohen, jeta e qytetarëve po rrezikohet, tentimi për të krijuar një realitet të ri po avancohet dhe shqiptarët po largohen çdo ditë nga ajo pjesë e vendit tonë. Qeveria duhet të jetë vigjilente dhe të reagojë sa më shpejt për t'i hequr barrikadat të cilat janë kthyer në punkte të Vuçiqit, si tentim për ndarjen e Kosovës. Për këtë, po e përsëris, qeveria e ka mbështetjen time të plotë”, ka deklaruar Krasniqi.

Sipas tij, KFOR-i ka bërë një punë të mirë deri më tani për ta ruajtur paqen, për çka ka falënderuar mirëpo, sipas tij, heqja e barrikadave është, para së gjithash, përgjegjësi e



Qeverisë së Kosovës. Lideri i PDK-së ka theksuar se në këto tri javë dy gjëra janë të sigurta. “E para, barrikadat i kanë vendosur grupet kriminale të orkestruara nga presidenti i Serbisë, Aleksandër

Vuçiq, me qëllim destabilizimin dhe nënshtrimin e Kosovës. E dyta, në inkurajimin e këtyre grupeve dhe krijimin e një realiteti të ri atje, po ndikon tej mase heshtja dhe mosveprimi i

qeverisë. Prandaj, siç kam bërë gjatë gjithë kësaj kohe, disa herë, po e bëj këtë thirrje përsëri sonte, uroj për herë të fundit: Reagoni! Hiqni barrikadat! Çdo minutë që po kalon, po rrezikon sovranitetin

dhe integritetin territorial të vendit. Qytetarët kanë votuar për qeveri që e qeveris krejt Kosovën e jo vetëm deri tek Ura e Ibrit. Andaj, mos u zbrapsni se do t'ju mbështesim të gjithë”, ka thënë Krasniqi.



## Mbahet edicioni i shtatë i "Vrapo Babadimër"

**PRISHTINË, 26 DHJETOR** - Një numër i madh personash kanë marrë pjesë në edicionin e shtatë të minimaratës humanitare "Vrapo Babadimër", e cila organizohet çdo dhjetor në Prishtinë. Qëllimi kryesor i kësaj ngjarjeje është rritja e donacioneve për t'i ndihmuar familjet e varfra në

Kosovë me rastin e festave të fundvitit. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se kjo është një iniciativë fantastike e organizuar me muzikë e performanca të bukura nga minimaratona humanitare e përvitshme "Vrapo Babadimër". "I lumtur që

hapësirat e qytetit po u rikthehen qytetarëve, edhe më i lumtur që si kryeqytet kemi mundësinë të mbështesim nisma prej të cilave synojmë gjithëpërfshirjen, duke siguruar pjesëmarrjen e shumë fëmijëve, nxënësve dhe personave të tjerë me aftësi të kufizuara", ka thënë Rama.



## Lladrovci falënderon qytetarët për bashkëpunimin e treguar gjatë këtij viti

**DRENAS, 26 DHJETOR** - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka mbajtur tubimin e dytë me publikun, ku raportoi para qytetarëve punën njëvjeçare të këtij viti. Temë diskutimi e këtij tubimi me publikun ishin aktivitetet e komunës të cilat janë kryer gjatë këtij viti. Fillimisht, fjalë hyrëse pati udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, i cili tregoi rëndësinë e këtij takimi duke shtuar se: Tubimi me publikun ka karakter informues për pjesëmarrësit mbi të arriturat dhe vështirësitë si dhe investimet kapitale. Ndërsa sa i përket punës njëvjeçare ka prezantuar kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, i cili fillimisht i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, njëherësh falënderoi administratorët e vendbanimeve për bashkëpunimin me ekzekutivin për t'u dalë në

ndihmë qytetarëve, projekteve të nivelit qendror e lokal, me propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet gjatë tërë vitit. "Ky vit po përmbyllet me sukses. Këto suksese presim të konfirmojnë edhe zyrtarisht se jemi komuna më e mirë me performancë në nivel të republikës. Presim grantin për vendin e parë, normalisht", tha Lladrovci. Kryetari Lladrovci në mënyrë të hollësishme paraqiti të arriturat, vështirësitë, aktivitetet si dhe projektet e realizuara nga drejtoritë komunale gjatë këtij viti. Ai shpalosi edhe dy projekte të cilat synohen të realizohen së shpejti: Projekti i objektit me hapësira komunale në vend të objektit të komunës së vjetër si dhe ndërtimi i sheshit të qytetit. Të pranishmit i parashtruan pyetje dhe sugjerime ekzekutivit për punën njëvjeçare, ndërsa kryetari Lladrovci i falënderoi



për sugjerimet e dhëna si dhe u dha përgjigje të gjithë atyre që adresuan pyetje rreth projekteve të përfunduara gjatë

këtij viti, por edhe projekteve në të ardhmen. Në fund, kryetari Lladrovci ua uroi të pranishmëve dhe të

gjithë qytetarëve të komunës së Drenasit festat e fundvitit, duke u dëshiruar gjithë të mirat në jetë.

## Përkujtohet heroi Ahmet Delia



**SKENDERAJ, 26 DHJETOR** - Nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Skenderajt, Fadil Nura, është përkujtuar heroi Ahmet Delia në përvjetorin e 110 të rënies, në një luftë përballë ushtarëve çetnikë të pushtuesit serb.

Nënkryetari i komunës, Sami Lushtaku, në fjalimin e tij para të pranishmëve të shumtë, duke lartësuar veprën e Ahmet Delisë dhe sakrificën e tij, ka thënë se trimi i Prekazit të Epërm u bë frymëzim për shumë burra të tjerë në Drenicë, për të mos e duruar pafundësisht pushtuesit serb në Kosovë. Në emër të pasardhësve të

Ahmet Delisë, të pranishmit i përshëndeti nipi i tij, Adem Ahmeti, duke i falënderuar për pjesëmarrje në shënim të kësaj ngjarjeje. Kurse në emër të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, foli kryetari i saj, Xhavit Jashari.

Me një fjalë rasti u paraqit edhe mbesa e Ahmet Delisë, Florije Murseli, ndërkaq mësimdhënësi Nezir Rama lexoi një historik të ngjarjes së luftës së Ahmet Delisë.

Në fund të fjalimeve stërmbesa Lediona Ahmeti u paraqit me një monolog kushtuar trimit që luftoi me sëpatë përballë pushtuesit të armatosur.

## Komuna e Mitrovicës ndan mirënjohje për pensionistët e arsimit

**MITROVICË, 26 DHJETOR** - Drejtoria e Arsimit në Mitrovicë ka ndarë mirënjohje për pensionistët e vitit 2022 në shenjë respekti dhe falënderimi për kontributin e dhënë në fushën e arsimit. Në këtë ceremoni e pranishme ishte drejtoresha e Drejtorisë Komunale e Arsimit, Drita Kadriu, e cila i ka falënderuar të

gjithë pensionistët për pjesëmarrje dhe kontribut jetësor në fushën e arsimit. "Ju jeni shumë të rëndësishëm për shoqërinë tonë, sepse jeni ju ata që e keni bërë historinë. Meritoni shumë sepse jeni ajo gjeneratë që në rrethana dhe kohë të vështira treguat një përkushtim të madh kombëtar

dhe nxorët kuadro që ndihmuar në formimin e shtetit tonë", ka theksuar drejtoresha Kadriu, e cila më pas i ka uruar të gjithë pensionistët. Ndërsa veteranët e arsimit u shprehën mirënjohës për vlerësimin e punës së tyre shumëvjeçare nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë.





## Rafuna: Kosova në rrezik nga recesioni ekonomik

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se ka shumë mundësi që vendet e Bashkimit Evropian të futen në recesion apo rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik në vitin 2023. Në atë rast, recesioni do të reflektohej edhe në Kosovë, thotë Rafuna në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë".

Rafuna, po ashtu, thotë se parashikimet për rritje ekonomike në Kosovë këtë vit "nuk do të jenë të mjaftueshme" për zhvillim dhe punësim.

Prodhimi dhe tërheqja e investimeve të huaja janë pikat kryesore ku duhet të fokusohet Kosova, thotë ai. Ai ka theksuar se rritja ekonomike në Kosovë këtë vit, sipas Bankës Botërore, nuk mund të jetë më shumë se 3.01 për qind, ndërsa një vit më parë ishte mbi 10 për qind. Çfarë e ndikoi këtë ngecje? "Janë disa elementë që e kanë nxitur këtë frenim. Lufta Ukrainë - Rusi ishte ajo e cila na çoi në ngritje të inflacionit, pastaj çmimi i lartë i energjisë elektrike dhe çmimet e larta të derivateve. Këta janë faktorët që ndikuan në ngadalësimin e rritjes ekonomike jo vetëm në vendin tonë, por edhe në rajon dhe Evropë", ka theksuar Rafuna.

Ai ka pohuar se do të ishte mirë që qeveria t'i mbështesë prodhuesit. "Në të kaluarën, nga qeveritë ka pasur



subvencionime të mëdha. Tani është një masë që ka ndërmarrë qeveria aktuale, siç është subvencionimi i interesit të kredisë për eksport, por duhet shkuar tutje, nuk mjafton vetëm kjo", është shprehur Rafuna.

Sa i përket ekonomisë në vitin 2023, ai ke përmendur dy pjesë. "Deri në qershor-korrik e shoh si një sfidë shumë të madhe. Siç janë duke shkuar trendët dhe sipas disa raporteve që kam arritur t'i lexoj, parashihet mundësia shumë e madhe që disa shtete të Bashkimit Evropian të hyjnë në recesion. Nëse tregu evropian hyn në recesion, ai automatikisht reflekton edhe në Kosovë. Tregu evropian nuk ka pasur recesion

nga viti 2008", ka deklaruar Rafuna.

Ai ka theksuar se furnizimi jo i qëndrueshëm me energji elektrike vazhdon të mbetet problem në Kosovë. "Është paralajmëruar për një dimër të vështirë në sektorin e energjisë. Si do të ndikojë kjo te bizneset? Ne kemi pasur takime me komunitetin tonë. Ministria e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, ka paralajmëruar qysh në gusht se do të ketë dimër të vështirë dhe rritje të çmimit të energjisë. Kjo ka shkaktuar pasiguri te bizneset. Nëse ndodh rritja e çmimit të energjisë elektrike, atëherë ajo do të reflektojë në rritjen e çmimit të produktit, për arsye

se biznesi e kalkulon në produkt dhe ai produkt i del qytetarit më shtrenjtë. E dyta, nëse ka reduktime të rrymës, prodhuesit tanë do të kenë probleme. Janë pajisje të teknologjisë së fundit dhe janë të ndjeshme. Gjithë lënda e parë që është në proces të prodhimit në momentin që ndalet rryma... derisa të aktivizohet gjeneratori, komplet ajo pjesë e lëndës së parë ose gjysmë produkti shkon dëm. Kjo është kosto shtesë për produktin tonë. Bizneset më kanë thënë se disa pajisje nuk e njohin gjeneratorin dhe nuk mund të aktivizohen me gjenerator, që është një problem i madh. Nëse rritet

çmimi i energjisë elektrike, duhet të shihet mundësia nga shteti që pjesën e ngritur të çmimit t'ua subvencionojë bizneseve në mënyrë që të mos e kalkulojnë në produkt - që më pas e paguan qytetari", është shprehur ai.

Bizneset gjatë këtij viti kanë raportuar për vështirësi në plotësimin e vendeve të lira të punës. Se sa ka ndikuar kjo në zhvillimin e tyre, tregon Rafuna. "Bizneset nuk mund ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre pa fuqi punëtore. Bizneset kanë lëvizur me rritjen e pagave për punëtorët, me qëllim të kushteve më të mira për punëtorë. Punëtorët që i kam takuar në këto biznese private nuk kanë shfaqur ankesa me çështjen e pagave apo kushteve të punës. Por, ikja e punëtorëve po vazhdon. Trendi i ikjes së punëtorëve është jo vetëm në Kosovë, por në gjithë Evropën. Ne duhet të ndërmarrim masa për ta ndaluar ikjen e të rinjve. Aktualisht ka shumë të rinj që diplomojnë në fakultete dhe nuk mund të gjejnë punë në Kosovë dhe po ikin jashtë vendit. Arsimi është një problem në Kosovë. Arsimi duhet të jetë në raport me kërkesat e tregut. Nuk mund të shkollosh quadro profesione që nuk i kërkon tregu. Në arsimin në Kosovë kjo ndodh", ka theksuar kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna.

## Bankat komerciale në Kosovë nuk paguajnë tatim në dividendë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Bankat komerciale në vend me kapital të huaj që po realizojnë rritje të fitimeve të mëdha nga viti në vit po tërheqin dividendat e tyre të larta pa paguar tatim për shtetin e Kosovës.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, nuk ka treguar për shumatat e dividendave të tërhequra më 2022 nga bankat, por i ka arsyetuar këto tërheqje. Mehmeti bën me dije se këto banka janë me kapital të huaj që tërheqin dividenda.

Sipas raportit të fundit të BQK-së, për dhjetë muaj të këtij viti bankat komerciale kanë pasur fitim të pastër 120.3 milionë euro. Norma e interesit ishte nën 6 për qind, derisa gjatë këtyre muajve ka arritur në 6.3 për qind. "Sektori bankar në Kosovë është storie suksesi sa iu përket investimeve të huaja. Prej 12 bankave komerciale që



veprojnë në Kosovë, 9 prej tyre janë me kapital të huaj. Kjo është inkurajuese edhe për ne

si Bankë Qendrore dhe për shtetin e Kosovës që sa më shumë të kemi investime të

huaja në Kosovë. Me sa më kujtohet mua, dividenda nuk tatóhet, por në përgjithësi është

inkurajues fakti që ato biznese që vijnë në Kosovë, vijnë për ta ndihmuar shtetin e Kosovës, por natyrisht që e kanë parasysh edhe fitimin e tyre. Tërheqja e dividendes është diçka e drejtë e tyre, të cilën mund ta realizojnë jo vetëm bankat, por secili biznes që punon dhe vepron në Kosovë", tha Mehmeti.

Pas një ndalesë të përkohshme nga ana e BQK-së, në tremujorin e fundit të 2021-s bankat komerciale me kapital të huaj u lejuan të shpërndajnë dividenda tek aksionarë në shtetin e tyre.

Në bazë të raporteve vjetore të tyre, 5 nga 11 bankat komerciale në vend, shpërndanë dividendë në vlerë mbi 96.6 milionë euro. Ndonëse këta miliona euro prej fitimeve të realizuar në tregun e Kosovës, për shkak se shumica e aksionarëve janë të huaj, këto miliona kanë dalë nga Kosova.




# SI E KA TRAJTUAR AT SHTJEFËN GJEÇOVI FESTËN E BUZMIT OSE KTHIMIN E MOTIT MBARË

Nga: Dr. Nexhat ÇOÇAJ  
(etnolog)

Gjatë shekujve të kaluar, populli shqiptar si shoqëri primitive ishte një shoqëri e përbërë kryesisht prej blegtorëve dhe bujqve, të cilët sipas nevojës shndërroheshin në luftëtarë për mbrojtjen e interesave të tyre dhe të shoqërisë në përgjithësi. Kanë ndodhur gjatë historisë, që shumë luftëra që kanë filluar për shkak të kullosave dhe uzurpimit të tokave të punës. Pra, jeta e tyre ishte e lidhur ngushtë me këto dy veprimtari kryesore. Andaj, duke qenë se me qindra vite ilirët, kanë jetuar duke u marrë me blegtori dhe bujqësi, ata pothuajse çdo herë kanë qenë të interesuar për motin që do të mbretërojë. "Dobësia e njeriut përballë natyrës dhe besimet, bënë që të lindin një tok rritesh, me anë të të cilave njeriu përpigjej të ndikonte mbi forcat misterioze, për t'ia sjellë mbarë gjatë vitit punët e tij." (1) Mbështetur mbi këtë bazë pagane, mund të thuhet se të gjitha ritet e këngët e festave të motmotit, janë të lidhura me interesat e bujkut dhe të blegtorit, të cilët nuk ngurojnë t'i shprehin dëshirat e tyre për sa më shumë prodhime bujqësore, për shtim të numrit të bagëtive dhe për shtim të krahut të punës, për të mundur t'i korrin rezultatet e punës. Gjatë paganizmit, kur njerëzit besonin në shumë zota, çdo stinë i kishte festat e veta dhe në shumë raste ritet e atyre festave ngjasonin në mes vete, sepse qëllimi i të gjithave ceremonive rituale ishte i njëjtë për blegtori e bujqësi. Shqyrtimi i këtyre zakoneve e besimeve me karakter bujqësor e blegtoral, na shpin në gjurmët e bashkësisë së

dikurshme, me prona e interesa të përbashkëta, të organizuar si fshatarësi e lirë mbi bazë farefisnore e territoriale, ashtu siç ishin të organizuar edhe popujt tjerë të botës si persët, grekët, romakët, arabët, bullgarët e popujt tjerë të Evropës e të Azisë. (2) Kthimi i diellit për verë, apo kthimi i motit mbarë, dikur në paganizëm, ishte festë, që i kushtohej diellit, përkatësisht fuqisë së tij, pasi në ditën e shënuar, pra më 22 dhjetor niste të zgjatej dita e të shkurtohej nata, pra thjesht, të kthehej dielli mbarë, siç e kujton kujtesa kolektive etnografike e shqiptarëve. "Deri në shekullin e pestë dhe të gjashtë, shprehja "Zoti ynë, dielli" u përdor nga të krishterët në lutjet e tyre fetare edhe nëpër faltoret e para të krishtera - kisha. E njëjta shprehje u përdor gjithashtu në liturgji derisa u ndryshua më vonë në "Zoti ynë, Zoti" (3) Prandaj, shumë nga ritet që sot aplikohen kryesisht nga të krishterët, në forma tjera aplikohen edhe nga banorët myslimanë dhe ato rite i kushtohen kthimit të motit mbarë, ndërsa të krishterët e njohin si Festa e Buzmit, festa e Krishtlindjes apo edhe në disa vende si Festa e Kolendrave. Dhe besimtarët e krishterë ngjashmërinë e riteve të popullsisë islame me atë të krishterë për këtë festë e kufizojnë si ndikim të krishtenizmit e rrallë përmendet si festë pagane. Më tej ata gjatë hulumtimit të tyre, pohojnë, nëse te fetë tjera hasin ndonjë gjë të përbashkët me fenë e tyre dhe se kjo ngjashmëri është produkt i ndikimit të krishterë. (4) Pavarësisht ngjyrimeve fetare, në shumë ceremoni dhe rite të kësaj kremte hasen




Faksimile nga dorshkrimi i Gjeçovit për festën e Buzmit Bujar, f.14.

elementet pagane, të cilat në fakt i gjejmë edhe te festat tjera pagane. Kështu për Festën e Kthimit të motit mbarë ose për buzëm, siç na bën me dije Shtjefën Gjeçovi, në shumë zona e gjejmë djegien e dëllinjave, element që e kemi edhe te festat pagane të pranverës si te Dita e verës ashtu edhe te zjarri i Shën Gjergjit. Që në fakt edhe këto festa kanë të bëjnë me diellin. Përdërisa Festa e Kthimit të motit mbarë ka për qëllim kthimin e diellit, ose nisjen e diellit për mbarë, në vestat e paraverës ndezja e zjarrit ka të bëjë me mbajtjen e diellit sa më gjatë, për arritjen e rezultateve në kulturat bujqësore. Në vazhdim, do përpigjejmë që të sjell disa nga mendimet e Shtjefën Gjeçovit për festën e Kërsëndellat, përkatësisht për Buzmin bujar, për të cilin ka bërë një hulumtim në disa vise të Shqipërisë së Veriut si në të gjitha zonat e Malësisë së Shkodrës, në Mirditë, ndërsa në Kosovë ka mbajtur shënime në

disa fshatra të Pejës, në Prizren në Zym dhe në fshatrat e Anadrinisë. Pavarësisht hulumtimeve dhe mbledhjes së materialit etnografik, që ka bërë Shtjefën Gjeçovi, për shumë arsye ky dorëshkrim nuk u botua ende, sepse institucioneve tona në Kosovë e pa të keqen edhe të atyre në Shqipëri, po ua përmende trashëgiminë kulturore u duket, sikur po i pickon në dritë të syrit. Unë pata fatin, që ta kopjoj e fotoj kësaj fletore me shënime, gjatë kohës sa po përgatitja librin "Të pathënat për Gjeçovin" dhe meqë janë të dhëna të pa publikuara do t'i referohem në shumë raste këtij dorëshkrimi, për ta shtjelluar Buzimin dhe ritet që lidhen rreth kësaj pjese të kësaj feste pagane. Gjithashtu para se në ndalem në përshkrimin e disa riteve të kësaj feste, në fillim duhet të theksoj se sot në mileniumin e tretë, gjithnjë e më pak këto rite po kremtohen. Jo pse tani po i

kundërshton kisha apo feja e krishterë, por se tani nuk kanë më kushte familjet as në fshatra e lere më në qytet që të kenë oxhak, ku ta vendosin buzmin e kushte tjera që i kërkonte shënimi i kësaj feste. Gjithsesi ne do të japim disa elemente interesante që i ka shënuar Gjeçovi në shënime të tij, që do t'i sjellim më poshtë, për të vërtetuar se Festa e Buzmit është kremtuar në shumë pjesë të vendit dhe ritet kanë ndryshuar varësisht nga vendi, pavarësisht besimit. Në lidhje me emërtimin e fjalës buzmi, sipas Eqrem Çabejt, është një fjalë e mbarë e shqipes, sepse e ka edhe Toskëria jugore, Gjirokastra, Himara, Vlora, por është edhe emër i një hunde të malit në ishullin Andros të Detit Egje, me banorë shqiptarë. (5) Çabej më tej sqaron se nga shumë autor është përmendur buzmi në vend të fjalës cung i prerë. Për këtë fjalë kanë dhënë shumë autor mendimet e tyre. Emërtimi buzëm, sipas Gjeçovit





na del në disa variante. Kështu në Malësinë e Shkodrës me fjalën buzmat/at: "...thirren dy gurë të gjatë që ngrihen mbi dy anë të votres e që thirren edhe Carôjt u thuhet ngjeti e unaktë u thuhet në Dukagjin." (6)

Ndërkaq në Gomsiqe, po sipas të dhënave që na ka lënë në dorëshkrim Shtjefën Gjeçovi buzëm i thonë drurit që vendoset në zjarr në Natën e Këshëndellave e që quan trup "Trupi i Natës së Këshëndellave". Të dhënat për Gomsiqe të Mirditës Gjeçovi na i sjell më 24. XII. 1908. Ngjashëm si në Gomsiqe në Shkodër druri që vendoset në oxhak në Natën e Këshëndellave quhet Trupi i Kshndellave. Ndërkaq sa i përket prerjes, bartjes dhe vendosjes në zjarr, sipas Gjeçovit ka disa ndryshime, por që në esencë nuk janë ndryshime të mëdha. Kështu në Shkodër Trupi i Kshndellave në zjarr shoqërohet edhe me tre thupra të hardhisë, tre thupra të ullirit, ndërsa në Gomsiqe të Mirditës, Trupi i Natës së Këshëndellave shoqërohet me disa remba të dëllinjave.


Po sipas At Shtjefën Gjeçovit në Dukagjin, Shalë, Shoshë Kir e në vende tjera druri që vendoset në vatër njihet si Trungu i votës, por njihet e thirret edhe si Buzmi. Me emërtimin buzëm Gjeçovi e shënon edhe në Zym, në fshatrat katolike të Anadrinit si në Velezhë e në Shpenadi.

Pavarësisht se kanë kaluar gati 100 vite, prej kohës sa Shtjefën Gjeçovi i mblodhi të dhënat për Festën e Buzmit ato nuk u botuan nga institucionet tona kulturore, e as nuk u cituan nga

studiuesit që u morën më vonë me këtë temë, që do të ishte një bazë e mirë për studimet e tyre. Në esencë Festa e Buzmit nuk ka pësuar shumë ndryshime në disa zona, ku ende aplikohet kjo festë pagane e "veshur" me petkun fetar, por përshkrimi që u ka bërë Gjeçovi është një thesar, që do të duhej ta marrin si model dhe si nismë themeltare për studimet e tyre për festat e motmotit, meqë edhe për festa tjera e aspekte mitologjike At Shtjefën Gjeçovi flet në këtë dorëshkrim të rrallë dhe shumë të dobishëm për etnologjinë shqiptare.

Sipas Gjeçovit, me ceremoni rituale të buzmit, "... më 24 dhjetor, në mëngjes herët njëri nga meshkujt e shtëpisë shkon në malin e vet dhe e pret Buzmin. Kërcuri i Buzmit duhet të jetë dru qarri (në Zym të Hasit), e ka mjedise ku prehet bungu, arra, hardhia, gështenja, qershia etj. Shtjefën Gjeçovi në dorëshkrimin e tij të datës 12.12. 1926, në fletoren e shënimeve, në lidhje me buzmin thekson se në Zym ka qenë traditë se si është shtëpia, ashtu edhe duhet të jetë buzmi. "... si të jetë shpia, do të jetë edhe buzmi: shpia e trashë buzmi i trashë, shpija e hollë edhe buzmi i hollë." (7)

Sipas Gjeçovit, gjatë kohës sa pritet buzmi në mal, duhet mbajtur që të mos bie në tokë, sepse nuk duhet ta prek tokën dhe në shtëpi duhet të bartet me krah e të mos prek në tokë, ndërsa degët e buzmit të madh, por edhe të buzmit të vogël, ngarkohen në qerre dhe sillen në shtëpi. Në fakt, bartja e buzmit nga vendi ku pritet e deri në



Faksimile nga sqarimit me anë të vizatimit nga At Shtjefën Gjeçovi për emërtimin e buzmit, dorëshimi i cituar f. 18.

shtëpi është pothuajse kudo njësoj, sepse kështu veprohet edhe në fshatrat e Anadrinisë, në Grazhdanik e në Nashac e Atmaxhë, ku ka banorë të besimit katolik. Mos prekja e drurit të buzmit në takë, ngjason edhe me përdorimin dhe bartjen e degëve të drurit të shelqes, thanës, frashrit, fletave të arrës e të druve tjera edhe për festat tjera të pranverës si për Ditën e Verës dhe për Shën Gjargj. Në Zym, nga të moshuar, kuptohet të lindur pas vdekjes së Gjeçovit, kujtojnë se buzmi është bartur me saj mbi dr. Po në të dhënat që na i ofron Gjeçovi mësojmë se nëse buzmi është i trashë dhe degët e trungut të buzmit janë të trasha sa mund të shërbejnë për buzme, ato degë quhen buzmat e vegjël, si emërtim i tillë njihet vetëm në Zym e jo edhe në vendbanimet tjera të krishtera. Dallimin që e vëren Gjeçovi të ritit e buzmit në Zym dhe në Përdri është se në Zym, ardhja e urmit në shtëpi mund të shihet nga shumë persona, ndërsa në fshatrat e Anadrinisë, kur të sillen buzmi në shtëpi nga mali nuk e shohin tjerët pos dy personave që janë caktuar nga i zoti i shtëpisë.

Ndryshime kemi edhe në lidhje me ruajtjen e buzmit pasi të sillen buzmi në shtëpi. Kështu në Zym të Hasit, kur sillen në oborr, buzmi mbështetet për shtëpi. Në orët e mbrëmjes i prehen degët dhe copëtohen. Pastaj, të gjithë anëtarët e familjes, përveç të zotit të shtëpisë dhe zojës së shtëpisë, të cilët rrinë afër vatrës, të tjerët dalin jashtë. Sipas moshës, nga më i vjetri e deri te më i ri, marrin copë të buzmit dhe degë dhe fillojnë të hyjnë brenda në shtëpi.

Ndërkaq në fshatrat e Anadrinisë, buzmit pasi hyn në oborr pritët në të dy anët pjerrtësisht dhe buzmi

përafërsisht është i gjatë 1 kuti ose më së shumti 84 Cm., ndërsa degët e dushkut nga i cili nxirret buzmi përzihen me drutë tjera që janë o oborr të shtëpisë. Krahas buzmit, që bartet në shinë, i pa pastruar deri në shtëpi, pritët edhe një dëllinjë, mundësisht ajo që ka kokrra më së shumti. Pastaj buzmi pasi të shënohet në tre vende me kryq të gdhendur, ai vendoset në mënyrë horizontale mbi thesin me kashtë, që mbështet në të djathtë të derës kryesore të shtëpisë dhe afër tyre vendoset edhe një sëpata dhe aty qëndrojnë për pak kohë, përkatësisht deri pak para se të shtrohet darka.


Përderisa në Anadrini buzmi shënohet në tre vende në Zym shënohet vetëm në një vend. Me këtë rast duhet të potencohet edhe fakti se vendosja e buzmit mbi thes me kashtë bëhet pas perëndimit të diellit të ditës së 24 dhjetorit, kur besohet se nata e kësaj nate është shkurtuar sa kërcen gjeli nga një tra në tjetrin, e që në fakt është shenjë se buzmi dhe dëllinja digjen në votër në shenjë të kthimit të motit mbarë, përkatësisht kthimit të diellit nga vera, që nisë pikërisht në këtë natë.

Pak para darke më i vjetri hyn i pari duke thënë: "Koftë mirë zoti i shpisë", e ai i përgjigjet: "Mirë se vjen! Me çka po vjen?" Ai i përgjigjet "Me sh'net e me bereqet e me të gjitha të mirat e Zotit" dhe i lëshon copat dhe pjesën kryesore të buzmit afër vatrës. Pastaj hyn tjetri, i cili po ashtu i përsërit fjalët e të parit, sikurse edhe i zoti i shtëpisë. Mirëpo, shton edhe: "Po vij me djem e me vajza e me miq e dashamirë", kurse tjetri pas tij vazhdon: "Po vij me lopë e kije, me dhi e dhenë, me kalë e magar (e kështu i përmend edhe shtazë të tjera): tjetri pas tij shton "Me

grunë, me kallamoq, me pemë e kunguj..." dhe kështu hyjnë të gjithë duke thënë nga diçka. Pastaj ulen rreth e rrotull vatrës. Aty i zoti i shtëpisë e vë pjesën më të trashë të buzmit në zjarr e mbi te edhe copat e tjera. Kryet e buzmit (pjesa e trashë) është i prerë pjerrtas, ku është i gdhendur kryqi. Ndërsa në fshatrat e Anadrinit, kjo mënyrë e hyrjes në dhomë e buzmit ndryshon dhe sipas subjekteve, me të cilat kam biseduar e përshkruajnë në këtë mënyrë:

I zoti i shtëpisë i cakton dy veta për ta sjell buzmin brenda në dhomën e burrave, të cilët pas dalin jashtë e marrin buzmin e përgatitur, kurse thesi me kashtë dhe sëpata mbesin në të njëjtin vend ku janë vendosur së bashku me buzmin. Personat e caktuar, pasi e marrin buzmin dhe degën e dëllinjës, sapo i afrohen derës së burrave, trokasin duke thirr: "O i zoti shpisë, a do misafirë?" I zoti i shtëpisë ua hap derën dhe u thotë "Hajdeni e mirë se u ka pru zoti!" Dy të caktuarit hynë brenda dhe ndalën sapo ekalojnë pragun e derës dhe dera mbetet e hapur, ndërsa i zoti i shtëpisë i pyet "Me çka po vini?" E ata i përgjigjen, duke qëndruar në vend "Me të gjitha të mirat e Zotit!" Dhe nisin personat duke i përmendur djem, vajza, nuse, gra burra, pra përmenden njerëzit, që i ka dhe duhen një shtëpie. Dy personat, që e mbajnë buzmin në mënyrë horizontale e mbi te degën e dëllinjës me koka, pasi t'i përmend të gjithë njerëzit e planifikuar e bëjnë një hap përpara në drejtim të oxhakut, që është në ballë të tyre dhe ndalojnë para të zotit të shtëpisë, i cili në ndërkohë edhe ai lëviz nga pas në drejtim të oxhakut.

Kur ndalojnë në hapin e dytë, dy




Faksimile nga dorëshkrimi i Gjeçovit për festën e Buzmit Bujar në Zym të Hasit, f.37



djemtë me buzmin në duar, i zoti i shtëpisë i pyet sërish “Me çka po na vini?”, ata i përgjigjen “Po vijmë me të gjitha t’mirat e Zotit. Po vijmë me dhenë e me dhi, me qengja e shqerra, me lopë e bullica, me kuaj e me gomarica, me pula e me shota, me qura e me gusa...” dhe përmenden të gjitha bagëtitë që i ka dhe që i nevojiten familjes. Pasi i përmendin siç thamë emrat e bagëtive e shpezëve, mbajtësit e buzmit e bëjnë edhe një hap përpara në drejtim të oxhakut dhe kur ndalojnë i zoti i shtëpisë edhe një herë i pyet: “Me çka po vini?” Ata i përgjigjen “Me të mirat e Zotit! Dhe nisin e i përmendin këtë herë të gjitha bereqetet, që i prodhon fusha, duke filluar nga gruri, elbi, tershana, thekna, misiri, pasulja, domatet, patatet, specat, por përmenden edhe pemët rrush, kumbulla, dardha molla e ftoj e çdo prodhim bujqësor, me të cilin merren ajo familje. Pas përmendjes në tre radhë të gjitha gjërave, djemtë, që e kanë buzmin i afrohen oxhakut, ku në oxhak është anash e vendosur një shishe me verë dhe një shishe me raki. Dhe me të arritur afër oxhakut, i zoti i shtëpisë ua mbush nga një gotë me raki ose me verë, dy djemve që e kanë ende buzmin në dorë. Djemtë i marrin gotat e rakisë, e lëvdojnë Krishtin, dhe ia urojnë festën të zotit të shtëpisë. Pasi djemtë ia

urojnë festën të zotit të shtëpisë, nga buzmi dytë marrin nga një rremb të dëllinjës me kokrra a dhe e hedhin në zjarr në oxhak të odës së burrave. Në të njëjtën kohë nga dega e dëllinjës, që është e vendosur në mes të buzmit ku është i gdhendur kryqi në mes, merr një rremb të dëllinjës me kokrra edhe i zoti i shtëpisë dhe e hedh një zjarr njëkohësisht me dy djemtë, që vazhdojnë ta mbajnë buzmin në dorë. Kur nisin të kërcasin kokrrat e dëllinjave në zjarr të pranishmit nisin e theksojnë me zë të lartë shprehjen “Gacë e karricë, bice e verdicë!” Me sa unë e kuptoj me shprehjen “Gacë e karricë” është nënkuptuar ndriçimi i zjarrit, imitim i diellit, kurse “bicë e verdicë” e ka kuptimin e bereqeteve bujqësore dhe blegtorale, meqë fjala verdicë përdoret në kuptimin e vedrës, ku mjelen delet dhe lopët, apo edhe ku është ruajtur bulmeti. (8)

“Kjoftë mirë këtu o i zoti i shpisë!  
O mirë se vjen e mirë se të pruni Zoti!  
O asht tuj ardhë Buzmi bujar!  
E me se po na vjen (pëvesin gjinja)  
Po vjen me grunë e me drithë,  
Me gja e me tagji  
Me dhen e me dhi  
Me majshit e me djelmi  
Me gra e me reja  
E me gjithafër t’mirash! (9)




Faksimile nga dorëshkrimet e Gjeçovit për buzmin në Zym të Hasit, f. 38.

Ushqimi i Buzmit – Përderisa buzmi siç e pamë në Zym të Hasit vendoset në zjarr të oxhakut në odë të burrave dhe në te mungon dega e dëllinjës, në fshatrat e Anadrinisë, sipas të dhënave të ofruara nga Gjeçovi mbledhura nga terreni buzmi me pjesën e degës së dëllinjës nga dy të rinjtë shkon në shtëpinë e zjarrit për t’u ushqyer me bereqete. Në shtëpinë e zjarrit ose te robnia, nuk përsëriten fjalët që i kanë përmendur në odë të burrave, por këtu para sa të vendoset buzmi në zjarr vendoset gjithçka nga diçka. Pasi të ushqehet buzmi me bereqete, kush ka dëshirë merr nga një rremb të dëllinjave dhe e hedhin në zjarr krejt deri sa të harxhohet dëllinja e në fund vendoset buzmi me bereqet në zjarr dhe digjet druri në mes e dy anët e buzmit nuk digjen të tëra. Shtjefën Gjeçovi në fletoren e shënimeve në dorëshkrim, gjatë qëndrimit të tij në Has dhe në Gjakovë, kishte vizituar disa herë edhe fshatrat katolike të Anadrinisë, që ai i quan të Podrimes dhe në kuadër të studimeve për festat e motmotiti kishte shkruar për Krishtlindjet

dhe mënyrën e kremtimit të tyre në këto fshatra. Kështu sipas dorëshkrimit të tij më 13 gusht të vitit 1926 kishte vizituar disa fshatra të Anadrinisë dhe në mes tjerash ka theksuar: “Si mbarë malet e Shqipërisë ashtu edhe në këto krahina lutet Buzmi bujar, duke qenë se banorët e këtyre anëve janë të dalur prej maleve të Shqipërisë... Natën e Kshndellave marrin një qerep dhe e mbështesin për votër, pastaj marrin disa kokrra gruri, kallamboqi e bimë të tjera e në rrënjë të së cilës e vënë nga një gacë, të cilën e marrin prej Buzmit. Ajo gacë që shuhet e mbetet në hi të bardhë, difton vjetin pjelluer, e ajo që mbetet në hi të zi difton vjetin e fisit. (10) E zonja e shtëpisë, pasi të digjet buzmi, i mbulon me hi të dy unat, dikur moti siç ka theksuar Gjeçovi janë mbuluar me çerep, në mënyrë që gacat të mos shuhen dhe kështu të mbuluar dy unat e buzmit qëndrojnë deri në mëngjes para se të del dielli e pas kësaj ceremonia hanë darkën e festës dhe shkojnë në kishë për ta përcjellë meshën e mesnatës. Shtrimi i lamit- Në këtë mënyrë, në mëngjesin e 25 dhjetorit, i zoti

i shtëpisë i thërret njerëzit e shtëpisë për ta shtruar lamën. Në fakt lema shtrohet me kashtë, që ka qenë vendosur te dera e shtëpisë dhe në fillim “vizatohet” me kashtë një rreth i madh dhe më pas bëhet një kryq i madh, sa është menduar se është lama, ku është fshirë drithi në korrik. I gjithë ky veprim bëhet nga një person i vetëm. Një tjetër e mban sëpatën në dorë dhe rri afër lëmit të shtruar siç quhet “vizatimi i kryqit në rreth prej kashte. Ndërsa personi i tretë i gjinisë mashkullore i ka dy unat e buzmit, i cili pasi “vizatohet kryqi, i përplas unat mes veti që të largohen nga unat fufleshkat në formë gace e të bien në lamë. Pastaj unat e buzmit vendosen në mes të kryqit. Ndërsa mbi una vendoset tepsia me laknorin e përgatitur enkas për këtë qëllim, ku mbi laknor ka pak djath. Pastaj mbushen gotat me rake dhe me raki lutet krishti dhe urohët festa siç urohen në mbrëmje. Pasi pihet rakia nga ata që duan e munden të pinë, e zonja e shtëpisë e merr tepsinë me pite dhe e fut në shtëpi. Ndërsa djali që e ka pasur unat, i merr nga lama dhe niset drejtë pemëve e pas tij shkon edhe fjali me sëpatë dhe u drejtohet pemëve “A po ban a t’pres?” “Ban, ban, mos e prej”. Në këtë mënyrë i “trembin” tri pemë dhe pastaj në pemën e tretë e vendosin njërin un të shoqëruar me një kryq kashte që është i përgatitur paraprakisht, kurse uni tjetër vendoset në hambar të misrit ose të grurit. Ndërsa në Zym kjo ceremoni sot aplikohet pas tre dite, e që Gjeçovi nuk e ka shënuar se cilën ditë ndodh, por ka theksuar se ceremonitë Zymit për buzmin kanë disa ndryshime. Në fund, duhet të theksoj se këto shënime me dorëshkrimet e Gjeçovit, duhet parë në prizmin krahasimtar, gjë që do t’i shërbejnë shumë studimeve tona në fushën e etnologjisë.



Faksimile nga dorëshkrimi i Gjeçovit për festën e Buzmit Bujar në fshatrat e Anadrinisë, f.32



Mënyrë e sjelljes së buzmit që aplikohet në Zym, foto N. Çoçaj



# FILOZOFI | Pyetja e parë e njeriut



Filozofia, dëshira për të ditur, lindi me pyetjet që njeriu filloi t'i bënte vetes dhe përgjigjet që përpigjej t'i jepte vetes. Mendimi perëndimor ia detyron lindjen e tij kureshtjes dhe zgjuarsisë së njerëzve të cilët, gati tre mijë vjet më parë, filluan të pyesin veten për perënditë dhe natyrën

Cila është origjina e gjërave? Cili parim rregullon natyrën dhe qeniet e gjalla? Cila është struktura e universit? Cili është funksioni i shpirtit? Dhe nga çfarë përbëhet? Këto janë pyetjet e para që njeriu i bëri vetes dhe kërkimi i një përgjigjeje çoi në lindjen e filozofisë.

Mendimtarët e parë të botës greke janë quajtur "para-Sokratikë", pra më herët se Sokrati. Megjithatë, filozofët e epokave të ndryshme dhe ndjekësit e doktrinave gjithashtu shumë të ndryshme nga njëra-tjetra i përkasin këtij grupi, megjithëse të bashkuar nga hulumtimi i natyrës dhe njeriut. Kemi dëshmi për këta mendimtarë falë filozofëve dhe studiuesve të mëvonshëm, si Platoni, Aristoteli, Plutarku, Diogjen Laerti, Stobaeusi dhe Simpliciusi; dhe, por vetëm në rastet më fatlume, në fragmente të shkruara. Megjithatë, ndikimi i tyre ishte i madh, pikërisht sepse ata nisën reflektimet dhe shtruan pyetje të cilat, shkaktuan debate shekullore dhe frymëzuan filozofët e mëvonshëm. Ata kanë qenë shpesh shkëndija që lejoi mendimin e mëvonshëm të ushqej, të rritet dhe të evoluojë. Një shembull i kësaj është filozofia e pitagorianëve, e cila edhe pse e fshehur nga një sekret mistik, ndikoi jo vetëm në zhvillimin e matematikës, por edhe në shumë mendimtarë, nga Platoni e deri te neoplatonistët, madje edhe në Rilindjen italiane.

## Shkolla e Miletit

Filozofët e parë para-Sokratikë që jetuan në Milet, në bregun

perëndimor të Anadollit, janë grupuar nën emrin e shkollës së Miletit. Thalesi, i cili u trajnuar në Egjipt, konsiderohet si i pari para-Sokratik dhe babai i filozofisë greke. Shkencëtar, matematikan dhe inxhinier, ai u bë i famshëm për parashikimin e eklipsit diellor të vitit 585 para Krishtit dhe matjen e lartësisë së piramidave, duke u nisur nga hija e tyre. Duke studiuar natyrën, Thales pohoi se ishte uji, ose parimi i lagështisë, ai që ishte baza e të gjitha gjërave. Vetë Toka, sipas filozofit, notonte mbi ujë.

Gjithashtu i përkiste të ashtuquajturës shkollë të Miletit edhe Anaksimandri, i cili lindi në vitin 610 para Krishtit. Sipas Diogjen Laertit, ai ishte i pari që vizatoi një hartë detare dhe duket se ai shpiku gnomonin, ose orën diellore. Ai shkroi disa vepra mbi natyrën dhe yjet, nga të cilat kanë mbetur vetëm disa fragmente. Ndryshe nga Thalesi, Anaksimandri përjashtoi që një nga katër elementët natyrorë (ajri, uji, toka dhe zjarri) mund të ishte parimi jetik i universit. Ai përcaktoi si elementin thelbësor *apeironin*, një substancë e papërcaktuar, e pakufizuar dhe pa cilësi, jashtë së cilës dallohen kundërvëniet parësore (i nxehti dhe i ftohti, e lagështa dhe e thata).

Më i riu i shkollës së Miletit ishte Anaksimeni, i cili identifikoi parimin e të gjitha gjërave në ajër: duke ndryshuar vazhdimisht gjendjen, ndryshon formën duke u bërë re, baltë, ujë, tokë; me pak fjalë, gjithçka.

## Parimi është numri

Pitagora lindi në Samos në vitin 570 para Krishtit. Ai ishte një filozof jashtëzakonisht i rëndësishëm për mendimin e mëvonshëm, mjaft të mendojmë se Platoni nuk ngurroi të bënte një udhëtim të gjatë në Itali për të thelluar njohuritë e pitagorianëve. Megjithatë, ajo që njihet për shkollën pitagoriane,

dihet vetëm falë dëshmive të filozofëve të mëvonshëm ose atyre pak teksteve që i shpëtuan kontrollit të vetë shkollës: në fakt, rregulli i fshehtësisë ishte në fuqi në komunitetin pitagorian.

Baza e teorisë së Pitagorës qëndron në besimin se bota mund të interpretohet përmes studimit të numrave, të cilët janë baza e gjithçkaje, dhe se harmonia e përsosur e natyrës rrjedh nga marrëdhëniet e tyre, siç ndodh edhe me lëvizjet e planetëve. Kozmologjikisht, Pitagorianët ishin të parët që hoqën Tokën nga qendra e universit dhe e zëvendësuan atë me një zjarr qendror.

Shkolla e Pitagorës, e cila kishte karakteristikat e një sekti fetar, bëri të konvertohen shumë njerëz dhe u rrit me kalimin e kohës. Ndër ndjekësit e saj ishin Filolausi, Alcmaeoni i Krotonit dhe Architasi.

## Gjithçka rrjedh, sipas Heraklitit

Një tjetër mendimtar i shquar ishte Herakliti, i cili lindi në Efes në bregun e Jonit dhe duket se arriti pjekurinë rreth vitit 500 para Krishtit. Megjithatë, duke qenë se i përkiste një familjeje prestigjioze në qytet, ai refuzoi një rol të lartë shoqëror për të qenë mendimtar, duke u dalluar shpejt për karakterin e tij disi antisocial. Ai përfundoi duke qenë një vetmitar, duke jetuar me manaferra dhe barishte. Kur shkroi librin e tij *Natyrë*, e depozitoi në tempullin e Artemidës që të mos binte në duar të këqija. Kur Sokrati e lexoi, duket se iu duk i jashtëzakonshëm, por shumë i vështirë, aq sa pohoi (të paktën sipas Diogjen Laertit) se vetëm një zhytës nga Delosi, pra i mësuar me thellësi të tmerrshme, mund ta kuptonte. Midis fragmenteve të ndryshme të errëta, filozofët kanë nxjerrë nga

Herakliti mësimin se të gjitha gjërat nuk janë kurrë të njëjta, por janë të zhytura në një fluks të përhershëm ndryshimi. Për më tepër, sipas Heraklitit, zjarri është, ndër katër elementët, ai që stimulon dhe i jep formë konkrete modelit të përjetshëm. Nga zjarri, të gjitha gjërat burojnë dhe pastaj rikthehen tek ai, në një proces ciklesh shumëvjeçare.

## Qenia dhe paradokset e Zenonit

Ksenofani ishte paraardhësi i asaj që historiografia e quajti shkollën e Eleas. I lindur në vitin 565 para Krishtit, ai ishte poet dhe rapsod dhe duhet të ketë pasur një jetë plot ngjarje. Ai kompozoi një vepër në heksametra me titull *Natyrë* dhe disa poezi. Pika kryesore e reflektimit të tij ishte hyjnorja: larg nga të qenit siç e imagjinojnë njerëzit, është uniteti i përjetshëm, i cili përshkon universin dhe e drejton atë përmes mendimit të tij. Parmenidi i Eleas, dishepulli i tij, mbështeti idenë e një qenieje unike, të palëvizshme, të përjetshme, të palindur, të pavdekshme dhe të pandashme. Mbrojtësi i tij i vendosur ishte Zenoni, i cili argumentoi kundër opinionit të përbashkët që shihte tek gjërat krijimin dhe ndryshimin. Ai u bë i famshëm për një sërë paradoksesh, të debatuar shumë nga filozofët gjatë shekujve, që synonin të demonstironin se shumëfishimi çon në kontradikta.

## Parimet e Empedoklit për dashurinë dhe urrejtjen

Lindur në Agrigento në vitin 492 para Krishtit, nga një familje e pasur, Empedokliu zbuloi filozofinë në një moshë shumë të re. Duket se ai dëgjoi filozofë të ndryshëm, si Ksenofani,

Parmenidi dhe Zenoni dhe për të studiuar mbi të gjitha magjinë dhe metempsikozën vendosi të bashkohej me pitagorasit.

Pas kthimit në vendlindje ai realizoi role të ndryshme, ndër to edhe atë të mjekut. Ai kishte një reputacion si magjistar dhe mrekullibërës dhe mori pjesë aktive në jetën shoqërore të qytetit. Ai shkroi disa vepra dhe mbi 400 vargje të poezisë. Për natyrën kanë ardhur deri në ditët tona. Empedokliu mbështeti ekzistencën e katër elementëve tradicionalë, të cilët do të lëvizeshin nga dy parime aktive: dashuria dhe urrejtja, të cilat bashkojnë dhe ndajnë elementët e parë. Ka shumë anekdota për jetën e këtij filozofi, vetëm mendoni se ka gjashtë versione të ndryshme të vdekjes së tij, ndër të cilat më i famshmi (por edhe jo shumë i besueshëm) thotë se ai u hodh në Etna në moshën gjashtëdhjetë vjeçare.

## Atomizmi i Demokritit

Demokriti ndoshta ka lindur në Milet, në një datë të pasigurt midis 472 dhe 457 para Krishtit. Ai u rrit në rehati dhe duket se, me vdekjen e të atit, hoqi dorë nga tokat e tij për të pasur një pjesë të parave për t'u përdorur tërësisht për udhëtime dhe studime me sa më shumë mësues. Gjerësia e interesave të tij dëshmohej nga veprat e shumta që ai shkroi për etikën, fizikën, matematikën dhe muzikën, nga të cilat kanë mbetur titujt dhe 200 fragmente. Pas Leucipusit, Demokriti u bë i famshëm për doktrinën atomiste, e cila thoshte se realiteti përbëhet nga atomet dhe zbrazëti. Atomet janë trupa të pafund në numër, të pandashëm, të barabartë në sasi, por të ndryshëm në formë dhe madhësi geometrike. Materializmi i Demokritit ishte shumë i suksesshëm dhe u adoptua kryesisht nga filozofia heleniste. / Në shqip nga bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Fitore me përmbysje e Pejës

**SUHAREKË, 26 DHJETOR** - Peja ka mundur Ponte Prizrenin me rezultat 83:91 (28:11, 19:27, 16:17, 11:19, 9:17), në një ndeshje ku ishte duke pësuar me 17 pikë dallim. Ndeshja u zhvillua në Therandë në kuadër të javës së 16-të të Prince Caffè Superligës. Prizrenasit e nisën ndeshjen më mirë dhe qysh në çerekun e parë filluan shpalljen, ku arritën epërsi deri në 17 pikë, 28:11, sa përfundoi kjo pjesë. Por, pejanët nuk u dorëzuan dhe dalëngadalë ngushtuan shifrat, ku arritën të afrojnë rezultatit në pesë pikë, 43:38, ndërsa pjesa e parë përfundoi 47:38. Perioda e tretë ishte tërësisht e barabartë, ku as prizrenasit nuk u shkëputën në rezultat dhe as pejanët nuk arrinin të afronin shifrat, ku rezultati pas 30 minutash ishte 63:55. Dhjetë minutat e fundit ishin shumë

interesante, ku Ponte e lëshoi epërsinë dhe Isiah Umipig, 13 sekonda nga fundi shënon për 74:74, duke e dërguar ndeshjen në vazhdimë, pasi Prizreni nuk ishte i efektshëm në aksionin e fundit. E, në vazhdimë herë njëra e herë tjetra skuadër kalonte në epërsi, ndërsa në fund verdhezinjtë ishin më të vëmendshëm dhe fituan 83:91. Te Ponte Prizreni më i miri ishte Wayne Arnold me 31 pikë, kurse te Peja u dalluan Jalen Tate me 17 pikë, Samir Zekiqi me 15 pikë e nëntë kërcime dhe Rodney Purvis me 20 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime. Prizrenasit kanë gjashtë fitore e nëntë humbje, ndërsa pejanët janë në vendin e parë me 12 fitore e tri humbje. Derbi i kësaj xhiro do të zhvillohet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës. Therandasit janë në formë shumë të mirë, duke



regjistruar nëntë fitore radhazi pas katër humbjeve, kurse bardhekaltrit kanë dhjetë fitore e katër humbje, ndërsa së fundi fituan edhe Superkupën e

Kosovës, andaj pritet një sfidë shumë interesante të mërkurën në Therandë. Takim shumë i rëndësishëm do të zhvillohet mes Vëllaznimit dhe Rahovecit.

Kuqezinjtë kanë gjashtë fitore e nëntë humbje, kurse Vreshtarët dy fitore e 12 humbje, prandaj pritet një duel jetik mes këtyre dy skuadrave, që duan të mbesin pjesë e elitës. Trepça do të ndeshet me rivalin e vjetër, Bashkimin. 'Xehetarët' kanë tetë fitore e shtatë humbje, ndërsa prizrenasit pesë fitore e dhjetë humbje.

### SUPERLIGA - Java 16

Ponte Prizreni - Peja  
83:91

**Të mërkurë takohen:**  
18:00 G. Eagle Ylli - Sigal Prishtina

**Të enjten takohen:**  
19:00 Vëllaznimit - Rahoveci  
19:00 Trepça - Bashkimi

## Muriqi për herë të dytë shpallet futbollist i vitit, Thaqi më i miri në Superligë

Prishtinë, 26 dhjetor - Sulmuesi i Kosovës dhe i skuadrës spanjolle, Mallorca, Vedat Muriqi është shpallur futbollist më i mirë i vitit 2022. Çmimin kryesor "Fadil Vokri" në mungesë të Muriqit, i cili është i angazhuar me skuadrën e tij, e pranoi drejtori i Kombëtares, Muharrem Sahiti, derisa atë e dorëzuan bashkërisht presidenti Agim Ademi dhe kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama. Pjesë e këtij eventi ishin edhe Daulina Osmani, zëvendësministrja e Sportit, presidenti i FSHF-së, njëherësh anëtar i KE të UEFA-s, Armand Duka dhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, derisa këtë event



me nga një telegram e përshëndetën i pari i FIFA-s, Gianni Infantino dhe ai i UEFA-s,

Aleksandër Çeferin. Për Muriqin ky është çmimi i dytë i futbollistit të vitit nga FFK, ngase herën e

parë e kishte fituar në vitin 2019. Ndërkaq, epiteti i futbollistit më të mirë 2022 në Superligë i takoi anëtarit të FC Ballkani, Armend Thaqi. Në 11-shen më të mirë të Superligës u zgjodhën: Enea Koliqi, Armend Thaqi, Lumbardh Dellova, Astrit Thaqi, Ardian Limani, Ermal Krasniqi, Lindon Emërllahu, Ilir Krasniqi, Endrit Krasniqi, Albion Rrahmani, Marko Simonovski. Ky i fundit e fitoi edhe çmimin e golashënuesit më të mirë të vitit. Futbollistja më e mirë e vitit u shpall Lumbardha Misini, derisa çmimin shpresa e vitit e fitoi Aurora Racaj. Me çmim u nderua edhe talenti i FC Bayer

Leverkusen, Larson Ferati. Epiteti i lojtarit më të mirë në futsall i takoi Dardan Topillës. Çmimi i klubit më të mirë të vitit i takoi FC Ballkani, çmimi 'Fair-Play' shkoi për FC Ferizaj, ai për klubin më të mirë të vitit tek femrat te KFF EP Hajvalia, derisa në futsall klubi më i mirë u shpall FC Liqeni. Epiteti i trajnerit më të mirë i takoi Ilir Dajës, i cili me FC Ballkanin pati arritje historike për futbollin e Kosovës, teksa gjyqtari më i mirë për herë të shtatë u shpall Genc Nuza. Me mirënjohje të veçanta u nderuan MKRS, Policia e Kosovës, UEFA, FSHF, FFM, FFSHF dhe UKSHF, si dhe sponsorët e FFK-së.

## U19 filloi grumbullimin e dytë



Prishtinë, 26 dhjetor - Të hënën janë grumbulluar hendbollistët e Kombëtares U19 të Kosovës. Grumbullimi i dytë po mbahet në Ferizaj, ndërsa nën urdhrat e kryetrajnerit Granit Sahiti hendbollistët e reja kanë zhvilluar stërvitjen e parë. Kombëtarja U19 do të ketë program të ngjeshur

deri më 30 dhjetor, ndërsa synim është rritja e konkurrencës dhe komponimi sa më i miri i ekipit kombëtar. Shumica e lojtareve janë të klubeve të vendit, ndërsa atmosfera është e shkëlqyer. Kombëtarja U19 do të ketë Evropian sfidues në verën e ardhshme. Do të paraqitet në

Kampionatin e Divizionit B, që do të mbahet në Prishtinë. Pos që do të ketë përkrahje të madhe, kjo Kombëtare do të ketë edhe presion shtesë që të paraqitet sa më mirë para tifozëve tanë. Evropiani U19 në Prishtinë mbahet prej 8 deri më 16 korrik 2023.

## KB Rahoveci zyrtarizon trajnerin e ri

Rahovec, 26 dhjetor - Ekipi i basketbollit Rahoveci, e ka emëruar trajnerin e ri të klubit, pas dorëheqjes së Muhammed Thaçit. Përmes

rrjeteve sociale, të hënën "Vreshtarët" e kanë prezantuar Daniel Nelsonin në krye të ekipit. Sipas njoftimit të ekipit, Nelson

menjëherë do të fillojë punën tek Rahoveci për ndeshjen e radhës, përballë Vëllaznimit. Aktualisht, Rahoveci është skuadra me rezultatet më të

dobëta në Superligën e Kosovës në basketboll. "Vreshtarët" janë në vendin e tetë me vetëm dy fitore e 12 humbje të pësuar.







### SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli:</b>	Zyrtar i Ri i Regjistrit të Kredive
<b>Departamenti/Divizioni:</b>	Divizioni i Regjistrit të Kredive
<b>Niveli i gradës:</b>	7 (shtatë)
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Divizionit të Regjistrit të Kredive

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Pranon kërkesat nga subjektet e të dhënave (fizik/juridik) në Regjistrin e Kredive për raporte të detajuara mbi kreditë;
- Shqyrton dhe gjeneron raportet e detajuara kreditore për subjektet e të dhënave; shqyrton dhe aprovon qasjen për të gjithë personat (fizik/ juridik) të regjistruar në portalin për qytetarë të Regjistrit të Kredive konform procedurave;
- Monitoron dhe kontrollon të dhënat e raportuara në Regjistrin e Kredive në aspekt të respektimit të dispozitave përkatëse dhe cilësisë së tyre të përgjithshme;
- Mban kontakte të rregullta me stafin profesional të anëtarëve të sistemit të Regjistrit të Kredive(RKK);
- Analizon kërkesat e parashtruara nga anëtarët e sistemit të Regjistrit të Kredive si dhe bën përcjelljen e tyre tek funksionet përkatëse;
- Hulumton mospajtimet mes anëtarëve të sistemit të Regjistrit të Kredive dhe subjekteve të të dhënave lidhur me saktësinë e informacioneve, në rast të evidentimit për pasaktësi të informacionit, reagon menjëherë me kërkesë për rishikim/korrigjim;
- Merr pjesë aktive në përgatitjen e raporteve statistikore rreth aktivitetit të RKK-së;
- Përcjell kryerjen e të gjitha pagesave të anëtarëve të RKK-së ndërlidhur me shërbimet e marrura nga sistemi i Regjistrit të Kredive si dhe pagesa të tjera të RKK-së;
- Merr pjesë aktive në takimet e rregullta me anëtarë të sistemit të RKK-së;
- Punë tjera që i caktohen nga udhëheqësi i divizionit ndërlidhur me funksionet dhe përgjegjësitë e Regjistrit të Kredive;

#### Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë Universitare në IT, Menagement, apo Financa;
- Aftësi për kycje të shpejtë në sisteme aplikative për nevoja financiare;
- Njohuri në procesin e dhënies së kredisë dhe tregut kreditor në përgjithësi paraqet përparësi;
- Njohja e mirë e punës me kompjuter – MS Windows, njohuri e sistemeve tjera relevante e preferuar;

#### Përvoja e punës:

- Përvojë pune në sektorin financiar paraqet përparësi;
- Përvojë në administrimin dhe analizën e të dhënave kreditore paraqet përparësi;

#### Njohja e gjuhëve të huaja:

- Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohuri e gjuhës angleze është e dëshirueshme;

#### Kërkesat e posaçme:

- Të mos ketë qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale;
- Mbajtje e lartë e fshehtësisë;
- Vëmendje në detaje dhe saktësi;
- Aftësi të shkëlqyeshme bashkërenduese; dhe
- Aftësi të mira komunikimi.

#### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Certifikatën nga gjykata e cila dëshmon, se nuk keni qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (jo më të vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se nuk jeni nën hetime (jo më të vjetër se 3 muaj).
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

#### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 10 janar 2023.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.



### OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Pozicija:</b>	Mladi službenik za kreditni registar
<b>Odeljenje/Divizija:</b>	Divizija kreditnog registra
<b>Nivo stepena:</b>	7 (sedam)
<b>Izveštava:</b>	Rukovodiocu divizije kreditnog registra

#### Radne dužnosti i odgovornosti:

- Prima zahteve od subjekata podataka (fizičkih/pravnih) u Kreditnom registru za detaljne izveštaje o kreditima;
- Pregleda i generiše detaljne kreditne izveštaje za subjekte podataka; ispituje i odobrava pristup svim licima (fizičkim/pravnim) registrovanim na portalu za građane Kreditnog registra u skladu sa procedurama;
- Prati i kontroliše podatke prijavljene u Kreditnom registru u pogledu usklađenosti sa relevantnim odredbama i njihovog opšteg kvaliteta;
- Održava redovne kontakte sa stručnim osobljem članova sistema Kreditnog registra (KRK);
- Analizira zahteve podnete od strane članova sistema Kreditnog registra i prosleđuje ih nadležnim funkcijama;
- Istražuje nesuglasice između članova sistema Kreditnog registra i subjekata podataka u pogledu tačnosti informacija, u slučaju dokaza o netačnosti informacija, odmah reaguje zahtevom za preispitivanje/ispravku;
- Aktivno učestvuje u izradi statističkih izveštaja o radu KRK;
- Prati izvršenje svih plaćanja članova KRK vezanih za usluge primljene iz sistema Kreditnog registra kao i druga plaćanja KRK;
- Aktivno učestvuje u redovnim sastancima sa članovima sistema KRK;
- Drugi poslovi koje poveri rukovodilac divizije u vezi sa funkcijama i odgovornostima Kreditnog registra;

#### Potrebne kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz IT, menadžmenta ili finansija;
- Sposobnost brzog uključivanja u aplikativnim sistemima za finansijske potrebe;
- Poznavanje procesa odobravanja kredita i kreditnog tržišta uopšte je prednost;
- Dobro poznavanje rada na računaru - MS Windows, poželjno poznavanje drugih relevantnih sistema;

#### Radno iskustvo:

- Radno iskustvo u finansijskom sektoru je prednost;
- Iskustvo u administraciji i analizi kreditnih podataka je prednost;

#### Poznavanje stranih jezika:

- Odlično poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika;

#### Posebni zahtevi:

- Da nikada nije bio predmet krivičnog dela;
- Visoko očuvanje poverljivosti;
- Pažnja prema detaljima i tačnosti;
- Odlične sposobnosti koordinacije; i
- Dobre komunikacijske veštine.

#### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propatno (motivaciono) pismo gde se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od MONT-a;
- Sertifikat suda kojim se dokazuje da nikada niste bili predmet nekog krivičnog dela (ne stariji od 3 meseca); i
- Potvrda policije kojom se dokazuje da niste pod istragom (ne starija od 3 meseca).
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu.

#### Procedura apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je 10. januar 2023. godine.
- Apliciranje se može izvršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK -a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Nepotpuna dokumentacija neće se razmatrati. Samo kandidati koji ispunjava uslove konkursa biće kontaktirani.



### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "SIMIT" - Sh.P.K, me pronar Muamer Çerkezi ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811899882 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SIMIT" - d.o.o., sa vlasnikom Muamer Çerkezi donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811899882 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "SIMIT" - L.L.C, with owner Muamer Çerkezi has taken the decision to quit its business with NUI: 811899882, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejta](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejta)

### RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Wildlife" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811446998.j.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

